



# STATUTI

Amenduar më 13 Gusht 2018

X

~

Signature



## STATUTI BANKES KOMBETARE TREGTARE SH.A.

Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve datë 31 Mars 2010  
dhe ndryshuar nga Asambleja e Përgjithshme të Aksionarëve në datat 31 Mars 2011; 28 Mars 2012; 27 Mars 2013; 17 Tetor 2014; 26 Mars 2015; 24 Mars 2016; 29 Mars 2017; 25 Tetor 2017; 27 Mars 2018 dhe 13 Gusht 2018.

### KAPITULLI I EMERTIMI, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

#### Neni 1

- 1.1 "Banka Kombëtare Tregtare" Sh.A. – ose shkurt, BKT (në vijim referuar si "Shoqëria" ose "Banka") është themeluar në formën e një shoqërie anonime, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në veçanti me ligjin "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" nr. 9901, datë 14.04.2008, (Ligji i Shoqërive Tregtare) dhe Ligjin "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" nr. 9662, datë 18.12.2006 ("Ligji Bankar").
- 1.2 Banka ka stemën dhe vulën e saj, që përbajnjë gërmat "BKT" në një formë të stilizuar. Konfiguracioni i saktë i vulës do të përcaktohet nga Këshilli Drejtues dhe mund të ndryshohet prej tij kohë pas kohe, duke ju nënshtruar kërkesave të legjislacionit shqiptar.

#### Neni 2

- 2.1 Zyra qendore e Bankës është në Tiranë, në adresën: Bulevardi "Zhan D'Ark".
- 2.2 Banka, me miratimin e Bankës së Shqipërisë, mund ta shtrijë rrjetin e vet, nëpërmjet hapjes së degëve, agjensive, zyrave të përfaqësimit brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe ofrimit të shërbimeve ndërkufitar, në përputhje me kërkesat e Ligjit Bankar.
- 2.3 Banka mund të investojë në blerjen e kapitalit të një shoqërie tjeter, jo-bankë ose institucion finansiar në përputhje me kërkesat e Ligjit Bankar.

#### Neni 3

- 3.1 Banka është themeluar për të kryer veprimtari bankare dhe financiare për një periudhë kohore të pacaktuar.
- 3.2 Banka, në përputhje me licencën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë si dhe me kriteret e përcaktuara në Ligjin Bankar, mund të ushtrojë aktivitetet e mëposhtëme:
  - (1) Pranimi i depozitave në para dhe i fondeve të ripagueshme nga publiku;
  - (2) Të gjitha format e kredidhënies, duke përfshirë edhe kreditinë konsumatore dhe hipotekare;
  - (3) Faktoringu dhe financimi i transaksioneve tregtare;
  - (4) Qiraja Financiare;



- (5) Të gjithashërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave;
- (6) Ofrimin e garancive dhe marrjen e angazhimeve;
- (7) Tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetëorganizuar (OTC) ose ndryshe, si më poshtë:
- Instrumente të tregut të parasë (çeqe, dëftesa, çertifikata depozitash etj.);
  - Këmbim valutor;
  - Produkte derivative (instrumente derivative), duke përfshirë, midis të tjera, kontrata të së ardhmes (futures) dhe kontrata me opsiione (options);
  - Instrumente të këmbimeve valutore dhe instrumente për vlerësimin e normës së interesit, duke përfshirë këtu produkte të tillë si marrëveshje *swap* dhe marrëveshje që përcaktojnë vlerën e interesit në të ardhmen (forward agreements);
  - Letra me vlerë të transferueshme;
  - Instrumenta të tjera të negociueshëm dhe aktive financiare, duke përfshirë veprimet me arin;
  - Pjesëmarrjen në emetimin e të gjitha llojeve të letrave me vlerë, duke përfshirë nënshkrimin dhe vendosjen si agjent (si publik, ashtu edhe privat) dhe kryerjen e shërbimeve lidhur me këto emetime;
- (8) Ndërmjetësimin për transaksionet monetare të mëposhtme:
- Administrimin e aktiveve të tillë si administrimi i parave dhe i portofolit, administrimi i fondevë, marrja në kujdestari, shërbimet depozituese dhe të besimit;
  - Shërbimin për kompensimin dhe shlyerjen e pagesave të aktiveve financiare, duke përfshirë letrat me vlerë, produktet derivative dhe instrumente të tjera të negociueshme;
  - Sigurimin dhe transferimin e informacionit finanziar si dhe përpunimin e të dhënavëve financiare e të programeve që kanë lidhje me të nga furnizuesit e shërbimeve të tjera financiare;
- (9) Shërbimet këshilluese, ndërmjetësuese dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimitaritë e listuara nga pika (1) deri në (9) këtu më sipër, duke përfshirë refrencën e kredisë dhe të analizës, kërkimin dhe këshillimin në lidhje me investimet dhe portofolin si dhe këshillimin mbi blerjet e mbi strategjinë dhe ristrukturimin e shoqërive.
- (10) Shërbimet e kujdestarisë për titujt e Qeverisë;
- (11) Emetimin dhe administrimin e instrumentave të pagesës (të tillë si kartat e kreditit dhe të debitit, çeqet e udhëtarit dhe çeqet bankare, kartat e pagesës dhe pagesat me cecular) etj., përfshirë emetimin e parasë elektronike.
- (12) Ndërmjetësimin ne aktivitetin e sigurimeve dhe risigurimeve.

- 3.3 Në përputhje më licencën e leshuar nga Banka e Shqipërisë dhe brenda limiteve të përcaktuara nga dispozitat ligjore në fuqi, banka mund të kryejë veprimtari të tjera si dhe mund të ofrojë shërbime të tjera fiananciare dhe bankare me kusht që këto aktivitete të janë të licensuara dhe të lejuara nga autoriteti perkates kompetent.

Neni 4

Organet e Bankës Kombëtare Tregtare janë si më poshtë vijon:

- a) Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve
- b) Këshilli Drejtues
- c) Drejtoria
- d) Komiteti i Kontrollit

## KAPITULLI II KAPITALI DHE AKSIONET

Neni 5

- 5.1 Kapitali i nënshkruar dhe tërësisht i paguar i Bankës është i barabartë me USD 300,000,000 (tre qindë milion USD), të ndara në 24,291,498 (njëzet e katërmilion e dyqind e nëntëdhjetë e njëmijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) aksione me vlerë nominale 12,35 USD (dymbëdhjetë US Dollarë e tridhjetë e pesë US cent) secili.
- 5.2 Aksionet e autorizuara numërohen nga 1 në 24,291,498, duke përfshirë dhe numrin e aksionit të fundit.

Neni 6

Aksionet janë nominative dhe të zakonshme. Çdo aksion i jep zotëruesit të tij të drejtën e një vote.

Neni 7

- 7.1 Aksionet janë të transferueshme sipas përcaktimeve të dispozitave të Ligjit të Shoqërive Tregtare, Ligjit Bankar dhe të këtij Statuti.
- 7.2 Çdo aksionar ka të drejtën e parablerjes mbi çdo transferim të propozuar aksionesh në përpjestim me kuotën ekzistuese në kapitalin aksionar.
- 7.3 Transferimi i titullit të pronësisë mbi aksionet si dhe krijimi ose transferimi i çdo të drejtë tjetër mbi to, regjistrohet në Regjistrin e Aksioneve, i cili duhet të mbahet në përputhje me Ligjin për Shoqeritë Tregtare dhe Ligjin Bankar.

## KAPITULLI III ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E AKSIONAREVE

Neni 8

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimarrës i Bankës.

- 
- 8.2. Në rastin e çështjeve që vendosen me shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme, vetem nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionarët, që zotërojnë më shumë se 50 për qind të aksioneve.
- 8.3. Në rastin e çështjeve, që vendosen me shumicë të kualifikuar, Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme, vetem nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionarët, që zotërojnë më shumë se 70 për qind të aksioneve.
- 8.4. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur në pikën 8.2 dhe 8.3 të këtij nenit, Asambleja do të mblidhet përsëri jo më vonë së 30 ditë, me të njëjtin rend ditë.

#### Neni 9

- 9.1. Çdo aksionar ka të drejtë të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionarëve, të shprehë mendimin e tij si dhe të ushtrojë të drejtat e votës në proporcione me numrin e aksioneve që ai zotëron.
- 9.2. Çdo aksionar mund të përfaqësohet nga një aksionar apo pëson tjetër i autorizuar mbi bazën e një prokure të posaçme me shkrim për ushtrimin e së drejtës dhe përdorimit të votës së aksionarit të përfaqësuar, në përputhje me procedurat dhe kufizimet e parashikuara nga Ligji për Shoqëritë Tregtare.

#### Neni 10

- 10.1. Asambleja e Përgjithshme thirret nga Këshilli Drejtues ose Drejtori i Përgjithshëm, ose çdo anëtar i Këshillit Drejtues, sa herë që shihet e nevojshme për mbarëvajtjen e Bankës, si dhe nga struktura/ subjekte, të cilave me dispozita të veçanta të Ligjit ju njihet kjo e drejtë në rrethana të caktuara. Thirrja bëhet nëpërmjet njoftimit të kryer me letër rekomande ose njoftim nëpërmjet postës elektronike, njoftim i cili i duhet dërguar aksionarëve – në adresën e vendqëndrimit të pasqyruar në Registrin e Aksionarëve – si edhe anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe Komitetit të Kontrollit, të paktën 21 (njëzet e një) ditë përpëra ditës së caktuar për mbledhjen.

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve duhet të thirret të paktën një herë në vit, për miratimin e bilancit vjetor brenda 4 (katër) muajve nga mbyllja e çdo viti ushtrimor financiar.

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve thirret për të gjitha rastet dhe sipas procedurave që parashikohen për këtë qëllim nga legjislacioni në fuqi.

- 10.2. Njoftimi i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve duhet të kryhet në përputhje me formën, përbajtjen, afatet dhe procedurat e parashikuara nga Ligji për Shoqëritë Tregtare.
- 10.3. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve mund të mbahen edhe në vende të tjera jashtë zyrës qendrore të Bankës.
- 10.4. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve do të konsiderohet se është mbledhur rregullisht edhe në rast se nuk janë respektuar procedurat që lidhen me thirrjen, me kusht që të janë të pranishëm apo të përfaqësuar të gjithë zotërueshit e kapitalit aksionar.

10.5 Asambleja e Përgjithshme mund të zhvillohet edhe nëpërmjet pjesëmarries së aksionarëve që ndodhen në vendë të ndryshme, të ndërlidhur me mjete telekomunikacioni të përshtatshme për komunikim kolektiv, në përputhje me parimet e mirëbesimit dhe të trajtimit të barabartë të aksionarëve. Thirrja, procedurat dhe detaje të tjera lidhur me zhvillimin/vlefshmërinë e mbledhjes të kryer me anë të mjeteve elektronike, do të kryhen në përputhje me kërkesat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare lidhur me këto lloj mbledhjesh.

10.6 Nëse Banka zotërohet nga një aksionar i vetëm, të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve ushtrohen nga Aksionari i Vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga Aksionari i Vetëm regjistrohen në regjistrin e vendimeve, të dhënat e të cilat nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Regjistrohen në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme:


- a. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b. shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
- c. zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
- d. vendimet për investime; dhe
- e. riorganizimi dhe prishja e Bankës.

#### Neni 11

- 11.1 Çdo mbledhje e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve drejtohet nga një aksionar ose nga një person tjetër i emëruar nga Asambleja e Aksionarëve
- 11.2 Kryetari duhet të verifikojë vlefshmërinë e pjesëmarries së personave të pranishëm, rregullsinë e thirrjeve dhe vlefshmërinë e mbledhjes. Kryetari përcakton rradhën e diskutimeve dhe procedurat e votimit.
- 11.3 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve duhet të nënshkruhen nga aksionarët ekzistues ose përfaqësuesit e tyre, si dhe nga Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes.

#### Neni 12

- 12.1 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme ose Aksionari i Vetëm, ka kompetencë ekskluzive për të marrë vendim në lidhje me çështjet e mëposhtme dhe nuk ka të drejtë t'ia delegojë këto kompetenca asnjë organi tjetër:
1. Ndryshime të Statutit;
  2. Miratimin e politikës së dividentëve, deklarimin e sasisë dhe mënyrave të pagesës së dividentëve përfshi ndonjë divident të ndërmjetëm;
  3. Miratimin e zmadhimeve dhe të zvogëlimeve të kapitalit;
  4. Bashkimin, shitjen, shpërndarjen, ndarjen dhe likuidimin e Bankës (përfshi çdo kontribut në natyrë të bërë në lidhje me një riorganizim të tillë);
  5. Ndryshime në emrin e Bankës;
  6. Krijimin e rezerveve të detyrueshme dhe rezervave të tjera;
  7. Blerjen nga Banka të aksioneve të veta;
  8. Emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar;
  9. Emërimin e likuiduesve;

- 
10. Emetimin e aksioneve dhe kushtet e nënshkrimit të tyre ose ndryshimet në vlerën nominale të aksioneve, monedhen në të cilën shprehen ose të drejta të tjera të lidhura me çdo aksion;
  11. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore të Bankës;
  12. Emërimin, dhe shkarkimin e anëtarëve të Komitetit të Kontrollit;
  13. Politikat e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe të Komitetit të Kontrollit;
  14. Ndryshimet e objektit të aktivitetit të Bankës;
  15. Miratimin e vlerësimeve të ekspertëve mbi kontributet në natyrë në kapitalin statutor; dhe
  16. Emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues;

#### Neni 13

- 13.1 Për çështjet e përcaktuara në Nenin 12.1, përfshirë paragrafet (1) deri në (10), Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve mund të marrë vendime të vlefshme me një shumicë të kualifikuar prej  $\frac{3}{4}$  (tre të katërtave) të aksionarëve pjesëmarrës në votim.
- 13.2 Për çështjet e përcaktuara në Nenin 12.1, përfshirë paragrafet (11) deri në (16), Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve mund të marrë vendime të vlefshme me një shumicë të aksionarëve pjesëmarrës në votim.
- 13.3 Mënyrat e votimit përcaktohen nga Asambleja e Aksionarëve dhe mund të jenë si vijon: me ngritje duarsh, duke thirrur emrat, votim i fshehtë ose përmes nënshkrimit të një vendimi të shkruar nga aksionarët, në përputhje me parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- 13.4 Për çdo vendim votohet në mënyrë të veçantë.

### KAPITULLI IV KESHILLI DREJTUES DHE DREJTORI I PERGJITHSHEM

#### Neni 14

- 14.1.1 Këshilli Drejtues është organi vendimarrës dhe mbikqyrës i Bankës, i cili përbëhet nga jo më pak se pesë (5) anëtarë dhe jo më shumë se nëntë (9) anëtarë.
- 14.2 Secili anëtar i Këshillit Drejtues duhet të plotësojë kërkesat e parashikuara në Ligjin Bankar.
- 14.3 Këshilli Drejtues emëron midis anëtarëve të tij një Kryetar dhe një Zëvendës-Kryetar si dhe një Sekretar i cili nuk duhet të jetë domosdoshmërisht anëtar.
- 14.4 Anëtarët e Këshillit Drejtues kanë të drejtë të rimbursohen për shpenzimet e kryera gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, si dhe të marrin një shpërblim i cili përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve.
- 14.5 Anëtarët e Këshillit Drejtues zgjidhen për një afat 4 (katër) vjeçar. Anëtarët Këshillit Drejtues mund të rizgjidhen per te njejtin mandat, pa kufizim.
- 14.6 Vazhdimesia dhe ndërprerja e detyrës, shkarkimi dhe zëvendësimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues duhet të bëhet në përputhje me parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe të Ligjit Bankar.

**Neni 15**

- 15.1 Këshilli Drejtues mblidhet së paku një herë në tre (3) muaj në selinë e Bankës ose në një vend tjeter, ose sa herë që konsiderohet e nevojshme nga Kryetari i Këshillit Drejtues ose kur një gjë e tillë kërkonit nga të paktën një e treta (1/3) e anëtarëve të Këshillit Drejtues ose të Komitetit të Kontrollit.
- 15.2 Njoftimi i mbledhjes që përmban orën, ditën, vendin ku do të mbahet mbledhja, si dhe rendin e ditës, duhet t'u dërgohet anëtarëve të Këshillit Drejtues, me postë, telegram, teleks, faks, e-mail ose çfarëdolloj mjeti tjeter elektronik i cili garanton marjen e tij, të paktën 5 (pesë) ditë përpresa datës së caktuar për zhvillimin e mbledhjes. Në raste urgjencë, afati i njoftimit mund të zvogëlohet deri në 48 (dyzet e tetë) orë.
- 15.3 Mbledhja e Këshillit Drejtues është e vlefshme me pjesëmarrjen e shumicës së anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave. Në rast të një barazimi të votave, vota e Kryetarit të Këshillit Drejtues është përcaktuese. Vendimet e Këshillit nënshkruhen nga anëtarët e Këshillit të pranishëm në mbledhjen përkatëse, qoftë fizikisht ose me anë të mjeteve të telekomunikacionit, si dhe nga Kryetari i Këshillit Drejtues dhe Sekretari.
- 15.4 Mbledhjet e Këshillit Drejtues mund të zhvillohen duke përdorur mjetet e telekomunikacionit. Në këto raste, mbledhja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari dhe Sekretari. Gjithashtu, për të gjithë pjesëmarrësit duhet të mundësohet identifikimi dhe ndjekja e diskutimit, pjesëmarja e drejtpërdrejtë në çështjet e trajtuara, si dhe duhet të mundësohet që ata të mund të marrin, japid ose shqyrtojnë dokumenta. Këshilli Drejtues mund të diskutojë dhe të marrë vendime dhe përmes e-maileve, dhe në të tilla raste vendimi do të konsiderohet "vendim qarkullues".

**Neni 16**

- 16.1 Këshilli Drejtues ka të gjitha kompetencat për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Bankës brenda objektit të veprimtarisë së saj, përvèç kompetencave që sipas ligjit ose këtij Statuti i rezervohen ekskluzivisht Asamblesë së Aksionarëve.
- 16.2 Këshilli Drejtues mund t'ia delegojë kompetencat lidhur me administrimin e Bankës, Drejtorit të Përgjithshëm dhe/ose organeve ekzekutive të saj, me përashtim të atyre kompetencave, delegimi i të cilave është i lidhur me kufizime të përcaktuara nga Ligji i Shoqërisë Tregtare ose Ligji Bankar.
- 16.3 Janë në kompetencën e Këshillit Drejtues vendimet lidhur me sa më poshtë:
- Emërimin dhe shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm, Drejtorëve të Grupeve dhe Divizioneve, anëtarëve të Departamentit të Kontrollit të Brendshëm, si dhe përcaktimin e shpërblimit dhe kompetencave të tyre;
  - Paraqitjen e bilancit vjetor kontabël në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionarëve dhe propozimet për shpérndarjen e dividentit;
  - Përcaktimin e planeve strategjike;
  - Krijimin e komiteve për drejtimin ekzekutiv të Bankës;
  - Hapjen dhe mylljen e degëve, agjensive dhe zyrave të përfaqësimit;

X

J.

S.

- Miratimin e çdo ekspozimi kredie që tejkalon vlerën 1.000.000 Euro (një milion Euro);
- Krijimin, pjesëmarjen apo transferimet e kapitalit në shoqëri tregtare të tjera, vendase apo të huaja;
- Blerjen, shitjen dhe shkëmbimin e aseteve fikse të trupëzuara ose të patrupëzuara me vlerë e cila tejkalon 250.000 Euro (dyqind e pesëdhjetë mijë Euro);
- Krijimin ose heqjen e kufizimeve që tejkalojnë 1.000.000 Euro (një milion Euro) në vlerë;
- Çdo huamarrje në formën e kredisë solidare (*sindicated loan*) ose borxhit të varur, që tejkalon 1.000.000 Euro (një milion Euro);
- Miratimin e Dokumentit të Politikave Operative; dhe
- Miratimin e planit të biznesit dhe buxhetit vjetor të Bankës.

### **Neni 17 DREJTORI I PERGJITHSHEM**

- 17.1 Këshilli Drejtues në përputhje me kërkesat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe Ligjit Bankar emëron Drejtorin e Përgjithshëm të Bankës. Në rast se një anëtar i Këshillit Drejtues emërohet si Drejtor i Përgjithshëm, ai ose ajo nuk mund të veprojë si Kryetar ose Zëvendës-Kryetar i Këshillit Drejtues dhe nuk mund të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit, në të cilat diskutohet dhe votohet emërimi ose shkarkimi i Drejtorit të Përgjithshëm.
- 17.2 Drejtori i Përgjithshëm i Bankës do të ketë në kompetencë të gjitha çështjet lidhur me administrimin e Bankës, të cilat në bazë të ligjit dhe këtij Statuti nuk janë objekt i vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, Këshillit Drejtues ose Komitetit të Kontrollit.

### **KAPITULLI V KONTROLLI DHE LLOGARITE**

### **Neni 18 KOMITETI I KONTROLLIT**

- 18.1 Komiteti i Kontrollit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve për një mandat 4 (kater) vjeçar, me të drejtë riemërimi.
- 18.2 Secili anëtar i Komitetit të Kontrollit duhet të plotësojë kërkesat e parashikuara nga Ligji Bankar.
- 18.3 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve përcakton shpërblimin vjetor të anëtarëve të komitetit të Kontrollit të cilët kanë të drejtë të rimbursimit të të gjitha shpenzimeve të kryera gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.
- 18.4 Anëtarët e Komitetit të Kontrollit kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve.
- 18.5 Organizimi, mbledhjet dhe kompetencat e Komitetit të Kontrollit do të rregullohen në përputhje me parashikimet e Ligjit Bankar.

- 18.6 Nëpunësit ekzekutive dhe drejtoret e Bankës nuk mund të emërohen si anëtarë të Komitetit të Kontrollit.



- 19.1 Banka do të mbajë bilancet dhe do të përgatisë raportet financiare në mënyrë të tillë që të garantojë një sistem korrekt dhe në përputhje me standartet dhe rregullat e kontabilitetit, të situates financiare te Bankës, në baza individuale dhe të konsoliduara.
- 19.2 Brenda afateve ligjore, Banka do të përgatitë bilancet dhe pasqyrat finançare në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me Ligjin "Për bilancet dhe pasqyrat finançare" si dhe në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.
- 19.3 Bilancet kontabile dhe llogaritë kontabile të fitimeve dhe humbjeve përgatiten nga Këshilli Drejtues dhe i komunikohen Komitetit të Kontrollit, së bashku me reportin ekonomik, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përparrë nga softimit të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve e cila duhet t'i shqyrtojë ato.
- 19.4 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve ka të drejtë të vendosë që fitimet të mos shpërndehen ose të kalohen në një fond rezervë ose të përdoren përritje të kapitalit.

## KAPITULLI VI TE NDRYSHME

### Neni 20

Në rast të likuidimit të Bankës në çdo kohë dhe për çfarëdolloj arsy, Asambleja e Aksionarëve përcakton mënyrën e likuidimit të Bankës dhe cakton një ose më shumë likuidatorë, duke përcaktuar kompetencat dhe shpërblimet përkatëse të tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### Neni 21

- 21.1 Pjesëmarrësit në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionarëve, në Këshillin Drejtues dhe në Komitetin e Kontrolit mund të përdorin materiale në gjuhën shqipe ose angleze.
- 21.2 Në rast të ndonjë konflikti lidhur me aktet dhe dokumentat e përmendura më sipër, versioni në gjuhën shqipe do të mbizotërojë.

### Neni 22

Të gjitha cështjet të cilat nuk janë parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të rregullohen nga parashikimet e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe nga Ligji nr.

9662, datë 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", si dhe nga parashikimet e legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Për dhe në emër të

BANKA KOMBETARE TREGTARE SH.A


AKSIONERI I VETEM


ÇALIK FINANSAL HİZMETLER A.Ş

Abdullah Kapı Yeraltı  


Datë 13.08.2018



  
Helmut Usta

  
M. Sancar Pınar

REPUBLIKA E SHQIPERISE

N O T E R I A

Nr. 1636 Rep.

Nr. 977 Kol.



V E R T E T I M

Sot ne Tirane, me 13.08.2018, (dymije e tetembedhjete), para meje noteres Eriketa Kokoli, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, me Seli ne rrugen " Sami Farsheri" pallati i Ri, u paraqiten personalisht:

- **Abdulvahap Yeroglu**, i datelindjes 19/05/1972, mbajtes i pasaportes turke me numer U 00356630, madhor dhe me zotesi te plete juridike, perfaquesues me Prokure i Z. Çalik Finansal Hizmetler A.Ş (Nr.19504, date 08 Gusht 2018 Ref. 2018/45. Noteri Publik Beşiktaş)

- **Mehmet Usta**, i datelindjes 18/01/1950, shtatas Turk, mbajtes i pasaportes me numer U00331832, madhor dhe me zotesite plete juridike, kryetar i Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme te Aksionereve,

- **Mehmet Seyhan Pencabligil**, i datelindjes 17/06/1969, identifikuar sipas ligjit me pasaporten Turke Nr. S00333999, madhor dhe me zotesi te plete juridike, i ftuar ne kete mbledhje te aksionereve te kryeje funskoinin e sekretarit, te cilet nenshkruan rregullisht para meje noteres Statutin (e ndryshuar) te Bankes Kombetare Tregtare - Sh.A, te miratuar me date 13 Gusht 2018 nga mbledhja e Asamblese se Aksionereve te BKT – Sh.A.

Une noteri pasi e gjeta konform nenit 39 te Ligjes 7829 date 1 Qershori 1994 " Per Noterine " e vertetova si me poshte.

N O T E R E

Eriketa Kokoli

